

VENDIM
Nr.673, datë 27.9.2006

PËR DHËNIEN E LEJES PËR HAPJEN E SHKOLLËS SË LARTË UNIVERSITARE, JOPUBLIKE
“ALDENT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 1, 12 e 13 të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënie e lejes për hapjen e shkollës së lartë universitare, jopublike “Aldent”, në emër të shoqërisë “Aldent”, sh.p.k., që do ta ushtrojë këtë veprimtari në qytetin e Tiranës.
2. Shkolla e lartë universitare, jopublike “Aldent” do të formojë specialistë të lartë në drejtimin:
- laborantë dentarë, 3 (tre) vite akademike.
3. Shkolla e lartë universitare, jopublike “Aldent” do të ofrojë studime në ciklin e parë të studimeve universitare. Në mbarim të studimeve, ky universitet do të japë diplomë universitare, me titullin “Laborant dentar”.
4. Shkolla e lartë universitare, jopublike “Aldent” do ta fillojë veprimtarinë në vitin akademik 2006-2007 dhe do të ketë sistemin e studimeve me kohë të plotë.
5. Ministria e Arsimit dhe Shkencës të bëjë verifikimin e plotësimit të kushteve për fillimin e procesit mësimor. Ndryshimet në vendndodhje, në stafin pedagogjik, planet dhe programet, si dhe në elementet e tjera, të miratuara, bëhen me miratimin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.
6. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kryerjen e procesit të vlerësimit e të akreditimit të kurseve të studimit dhe për zbatimin e ligjshmërisë në këtë institucion.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha